



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241743

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004688

C-IV.-14-3311

Ankuesit

M S nga f.sh D e P K.Podujevë.

Kundër

E paditura

N.SH “FAN Zahir Pajaziti”, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakërishte- rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Murat Hulaj, me dt.31 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET pjesërisht** ankesa si e bazuar dhe **NDRYSHOHEN**, Vendimit nr. PRN046-0278 i dt.15 prill 2014.
- II. **OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit M S në emër të në emër të tri pagave të pa paguara shumë prej **660.00€**, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore ti paguaj shumë prej **66.00€**.
- III. Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- IV. **OBLIGOHET** e paditura që paditëses të ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej **104.00€**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.29 prill 2014, ankuesi ka paraqitur ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN046-0278 i dt.15 prill 2014 me të cilën i është refuzuar kërkesa për kompensim për tri pagat të pa paguara nga NSH FAN “Zahir Pajaziti”. Në ankesë ka pohuar se vlerësimi i dhënë nga AKP është i përgjithësuar dhe jo konkret. Ka shtuar se ka qenë në marrëdhënies pune të përhershme te e paditura dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë për shkak se NSH është futur në likuidim. Kësaj ankese i ka bashkangjitur Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Listën e 20%.

Me dt.23 korrik 2024, e paditura AKP parashtrori mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të drejtë të dispozitave ligjore. E paditura pohoi se ankesa është e pa pranueshme pasi që konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekti i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria. Në këtë kontekst 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimet se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur të Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL-ja me marrjen e vendimit. Argumenti tjetër në përgjigjen e parashtruar të AKP-së është se pretendimet e parashtruesit për kompensim për tri paga janë të parashkruara. Në varësi të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda 3 vjetësh nga koha kur parashtruesi ka fituar të drejtën të kërkoj kompensim. Në fund e paditura AKP propozon gjykatën që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe pa bazuar.

Gjykata me dt.17 korrik 2024, ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore dhe atë kopjen e librezës së punës, listën e pagave që pretendon se NSH i ka mbetur borxh si dhe prova tjera me të cilat i mbështet pretendimet ankimore. I autorizuari i ankuesit i është përgjigjur urdhrorit me dt.30 korrik 2024 duke bërë dorëzimin e kopjes së njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjes së listës së pagave dt.31.03.2006, Listën e 20%.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuara i AL-së

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësar apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit” .

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Fan Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për tri paga. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjes së listës së pagave dt.31.03.2006, Listën e 20% si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga Lista e rrogave të mbetura borxh të dt.31.03.2006, vërtetohet fakti se ankuesi kishte tri paga të papaguara nga NSH në shumë prej 869.38€.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara listën e tri pagave të dt.31.03.2006, librezën dhe njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH-në dhe se NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e tri pagave të lëshuar nga personi përgjegjës i NSH, të nënshkruar dhe të vulosur.

Me rastin e aprovimit të shumës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata është bazuar në listën e tri pagave të cilat janë të nënshkruara nga Drejtori financiar Sh M, si dhe nga Drejtori N L. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 660.00€. Ankuesit gjykata i ka njohur tri paga të pa paguara në shumë prej 660.00€, ashtu siç ia kishte pranuar NSH-ja në listën e tri pagave të pa paguara të nënshkruar nga personat kompetente të ndërmarrjes por se ankuesi kishte kërkuar vetëm 660.00€.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Po ashtu, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 26 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështu nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera,

të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 26 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njëherë një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168 , AC-I-20-0183 etj.)

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi M S, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri paga në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 66.00€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

OBLIGOHET e paditura AKP, që përfaqësuesit të ankuesit t'ia paguaj shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës në shumën prej **104.00€** ashtu që për: hartimin e padisë në shumë prej 104.€.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrihet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r i
Murat Hulaj